



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

# **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL “GALANTERI”**

**Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar niveli III të KEK<sup>2</sup>**

**D4-III-16**

**Tiranë, Gusht 2016**

---

<sup>1</sup>Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup>Korniza evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Galanteri			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar niveli III të KEK	D4-III-16
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Galanteri”, niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin dhe konfeksionimin e aksesoreve dhe veshjeve prej lëkure, si dhe të zhvillojë individin, jo vetëm nga ana profesionale, por edhe personalitetin e tyre në mënyrë që të jetojnë në përshtatje me mjedisin që i rrethon.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në institucionet që ofrojnë arsim profesional në kualifikimin profesional “Galanteri” niveli III në KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: , referuar niveli III të KEK,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë përfunduar kualifikimin profesional “Tekstil-Konfeksion”, niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK;</li> <li>- janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Galanteri”, niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të këtij niveli si punonjës i kualifikuar në këtë fushë, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të aksesoreve dhe veshjeve prej lëkure, në punishte të ndryshme artizanale dhe atelie mode apo të vetëpunësohet.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, (menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	Nuk ka			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

**Rezultatet e të nxënit në:**

## **NJOHURI**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Galanteri” niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të si më poshtë:

### **Organizimi i punës dhe komunikimi**

- Të përshkruajë legjislacionin e punës, organizimin dhe funksionimin e një biznesi;
- Të përshkruajë mënyrën e realizimit të një plan biznesi;
- Të listojë metodat e komunikimit dhe rëndësinë e një komunikimi profesional;
- Të përshkruajë rëndësinë e të dëgjuarit dhe të kuptuarit në një komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e shprehjes saktë dhe në mënyrë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e punës në ekip/grup dhe parimet kryesore;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes të kostos;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes kohës së punës;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes bazës materiale

### **Sigurimi teknik**

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të materialeve të punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinave të ndryshme të qepjes;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës gjatë punës;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes së mjedisit;

### **Llojet dhe teknikat e përpunimit dhe punimit të lëkurës**

- Të përkufizojë termin galanteri dhe fushat specifike ku gjen vend përdorimi i lëkurës p.sh.:
  - Aksesorë: (rripa, kuleta, çanta, valixhe, doreza, kapele, kasketa, etj.)
  - Këpucë : (pupa, papuçe, sandale, këpucë, çizme, etj.)
  - Veshje : (funde, pantallona, jelekë, xhaketa, xhupa, etj.)
  - Arredim: (tapiceri kolltukësh, karrigesh, pupash, tavolina, etj.);
- Të përkufizojë materialet e galanterisë ( llojet e lëkurave, cilësitë e shtresave të lëkurës, etj.);
- Të listojë proceset e përpunimit të lëkurës dhe materialeve të tjera të galanterisë;
- Të përshkruajë përfitimin e lëkurave kamosh ( nga çarja ose ndarja e lëkurës në tre

ose katër shtresa);

- Të përshkruajë veçoritë e lëkurës për shollë (si butësinë, shkëlqimin, hollësinë dhe elasticitetin);
- Të listojë veti specifike të materialeve të galanterisë;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes dhe montimit të galanterisë;
- Të përshkruajë mjetet dhe makinat e qepjes së lëkurës;
- Të listojë materialet ngjitëse (bimorë, lateks, sintetikë, neoprenë);
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinave të qepjes së lëkurës;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinerive të llojeve të tjera të qepjes dhe montimit të materialeve të lëkurës për galanterinë (perçina, brima, zogëza, sumbulla, astarë, etj.);
- Të listojë mjetet dhe pajisjet e punës së galanterisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre (gërshërë, thika, pinca, shtiza, gjilpëra, etj.);
- Të përshkruajë llojet dhe teknikat e qepjeve me dorë, si mundësi dhe pasurim i montimit të pjesëve në galanteri;
- Të përshkruajë aksesorët ndihmës të galanterisë si: (tabanet e shollës dhe gomës tek këpucët, zinxhirët, astarët, perçinat, sumbullat, zogëza, etj.);
- Të përshkruajë përdorimin e lëkurës në veshje trupi (xhaketa, xhupa, jelekë, funde, pantallona, etj.);
- Të përshkruajë përdorimin e lëkurës në kombinim me materiale të tjera;
- Të përshkruajë përdorimin e lëkurës në veshje këmbë (këpucë, sandale, çizme, papuçe, pupa, etj.);
- Të përshkruajë përdorimin e lëkurës në aksesorë veshjeje, si në doreza, rripa, kapele, etj.;
- Të përshkruajë përdorimin e lëkurës në çanta, kuleta, portofola, etj.;
- Të përshkruajë përdorimin e lëkurës në arredim (tapiceri kolltukësh, pupa, karrige, divane, shtroje, etj.).

### **Teknikat e realizimit të rripave**

- Të përshkruajë materialet e lëkurës dhe aksesorët që përdoren për rripat në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të përshkruajë rëndësinë e elasticitetit të lëkurave për rripa;
- Të klasifikojë modele të ndryshme të rripave;
- Të klasifikojë kategoritë e rripave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;
- Të përshkruajë hapat e kalimit nga skica artistike në skicë teknike dhe pastaj në kartë-model;
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të kartë-modeleve të prerjes për rripat;
- Të përshkruajë mënyrën e montimit të të gjitha pjesëve të rripit;
- Të përshkruajë përzgjedhjen e aksesorëve sipas modeleve;

### **Teknika e realizimit të kapelave**

- Të përshkruajë materialet e lëkurës dhe aksesorët që përdoren për kapelat në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të klasifikojë modele të ndryshme të kapelave prej lëkure;
- Të klasifikojë kategoritë e kapelave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;

- Të përshkruajë pjesët përbërëse të kapelave duke përdorur fjalorin e duhur profesional;
- Të përshkruajë se si të kalojë skicën artistike në skicë teknike dhe pastaj në kartë-model për kapele;
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të disa kartë-modeleve të thjeshta të prerjes së kapelave;
- Të përshkruajë mënyrën e montimit të të gjitha pjesëve të dy modeleve për kapele.

#### **Teknika e realizimit të dorezave**

- Të përshkruajë materialet e lëkurës (me shkëlqim dhe kamosh) dhe aksesorët që përdoren për dorezat në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të përshkruajë rëndësinë e elasticitetit të lëkurave për doreza;
- Të klasifikojë modele të ndryshme të dorezave prej lëkure;
- Të klasifikojë kategoritë e dorezave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;
- Të përshkruajë pjesët përbërëse të dorezave duke përdorur fjalorin e duhur profesional;
- Të përshkruajë se si të kalojë skicën artistike në skicë teknike dhe pastaj në kartë-model për doreza;
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të disa kartë-modeleve të thjeshta të prerjes së dorezave;
- Të përshkruajë mënyrën e montimit të të gjitha pjesëve të dy modeleve të dorezave.

#### **Teknikat e realizimit të çantave**

- Të përshkruajë materialet (me shkëlqim dhe kamosh) dhe aksesorët që përdoren për çantat në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të klasifikojë modele të ndryshme çantash;
- Të klasifikojë kategoritë e çantave sipas stilit dhe funksionit si: çanta për blerje (trajsë), biznesi, kuleta, sportive, etj.;
- Të përshkruajë pjesët përbërëse të çantës duke përdorur fjalorin e duhur profesional;
- Të klasifikojë çanta të llojeve të ndryshme në lidhje me llojin e trupit të çantës si: çante e fortë, çantë e butë, me pjesë të përziera;
- Të përshkruajë sesi të kalojnë skicën artistike në skicë teknike për ta transformuar më pas në kartë-model;
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të kartë-modeleve të prerjes të disa llojeve bazë çantash;
- Të përshkruajë mënyrën e montimit të të gjitha pjesëve përbërëse të çantës.

#### **Teknikat e realizimit të veshjeve me lëkurë**

- Të përshkruajë materialet e lëkurës dhe aksesorët që përdoren për realizimin e veshjeve të tilla si: fund, pantallona, jelek, xhaketë;
- Të përshkruajë rëndësinë e elasticitetit të lëkurave për veshje;
- Të përshkruajë modele të ndryshme të veshjeve të tilla si: fund, pantallona, jelek, xhaketë që realizohen me material lëkure;
- Të përshkruajë se si të kalojë skicën artistike në skicë teknike e pastaj në kartë-model;

- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të kartë-modeleve për fund dhe jelek;
- Të përshkruajë mënyrën e montimit të të gjitha pjesëve përbërëse të fundit dhe të jelekut.

#### **Teknikat e realizimit të këpucëve**

- Të përshkruajë sistemin ndërkombëtar të masës së këpucës;
- Të përshkruajë materialin e lëkurës në lidhje me formën dhe estetikën e këpucës;
- Të përshkruajë llojet dhe tipologjinë e këpucëve të tilla si: këpucë burrash elegante; dhe casual, këpucë për femra me taka dhe të sheshta, me gomë apo me shollë, atlete;
- Të përshkruajë rolin dhe funksionin e shollës, të pjesës së gishtave dhe fortesën të thembra;
- Të përshkruajë mënyrën si të kalojë skicën artistike në skicë teknike e pastaj në kartë-model;
- Të përshkruajë mënyrën e realizimit të kartë-modeleve të këpucëve më të thjeshta: si balerina (pupa ose opinga);
- Të përshkruajë mënyrën e montimit të të gjitha pjesëve përbërëse të këpucëve balerina (pupa ose opinga).

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Modelim” niveli III në KSHK, individi do të përforcojë shprehitë profesionale të fituar në Nivelin III, si dhe do të zotërojë shprehitë profesionale, si më poshtë:

#### **Organizimi i punës dhe komunikimi**

- Të komunikojë në mënyrë profesionale me klientin;
- Të kuptojë kërkesën e klientit dhe të marrë pjesë në ndërtimin e elementëve të një modeli të kërkuar;
- Të punojë në grup / ekip duke bashkëpunuar me sektorët e tjerë;
- Të diskutojë në mënyrë profesionale me kolegët në vendin e punës;
- Të respektojë komunikimin sipas hierarkisë;
- Të zbatojë orarin e punës dhe detyrat sipas përshkrimit të vendit të punës;
- Të ndërtojë një plan të thjesht biznesi;
- Të zbatojë dokumentacionin/etiketat që shoqërojnë një veshje;
- Të zbatojë legjislacionin e punës në të gjithë elementët e tij;
- Të llogaritë kosto të bazës materiale të punës;
- Të llogaritë kohës e punës për modele të ndryshme;
- Të punojë në ekip/grup duke zbatuar parimet e punës në ekip;

#### **Sigurimi teknik**

- Të respektojë standardet e profesionit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të materialeve dhe mjeteve të punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;

- Të zbatohet rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinave të ndryshme të qepjes;
- Të zbatohet rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
- Të zbatohet rregullat e higjienës gjatë punës;
- Të zbatohet rregullat e mbrojtjes së mjedisit;

### **Llojet dhe teknikat e përpunimit dhe punimit të lëkurës**

- Të përcaktojnë ndarjen lëkurave tregtare (ose të regjura);
- Të përcaktojnë lëkurat që përdoren për pjesën e sipërme dhe të poshtme;
- Të kryejnë ndarjen e lëkurave të gatshme sipas përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë lëkurat që përdoren për veshje;
- Të dallojnë ngjitesit e lëkurës (bimorë, lateks, sintetikë, neoprenë);
- Të përcaktojnë llojet e perit për këpucë dhe galanteri;
- Të identifikojnë llojet e lëkurave sintetike dhe zëvendësuesit e tyre;
- Të kryejnë ndarjen e lëkurave kamosh sipas përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e astarëve që do përdoren në galanteri;
- Të identifikojnë llojet e lëkurës dhe karakteristikat e tyre;
- Të identifikojnë materialet e galanterisë (llojet e lëkurave, cilësitë e shtresave të lëkurës, etj.);
- Të skicojnë elemente të thjeshtë galanterie;
- Të lexojnë skica të ndryshme të elementeve të thjeshtë të galanterisë;
- Të lexojnë skema të thjeshta të makinave të lëkurës dhe galanterisë;
- Të realizojnë punime me dorë në lëkurë;
- Të specifikojnë mënyrat e hollimit të lëkurës (me anë të thikës pasi është lagur);
- Të përzgjedhë materialet e mjetet punës për procese pune të ndryshme;
- Të përdorin teknikat e qepjes dhe montimit të galanterisë;
- Të përdorin makineritë e qepjes së produkteve të galanterisë;
- Të përdorin makina, pajisje të llojeve të ndryshme të galanterisë (vrirë, perçina, sumbulla, makineri prerëse, etj.);
- Të skicojnë modele të thjeshta aksesorësh për meshkuj e femra të tillë si këpucë, veshje etj., për galanterinë;
- Të ndërtojnë kallëpet me shenjat përkatëse të referimit për punën që do të kryejnë me lëkurë dhe materialet e tjera;
- Të kontrollojnë saktësinë e skicave;
- Të korrigjojnë defektet e skicave;
- Të përzgjedhë lëkurën ose peliçen me aksesorët e përshtatshëm për modelin e zgjedhur;
- Të përzgjedhë aksesorët e nevojshëm funksionalë dhe dekorativë (fije, zinxhirë, shirita, astarë e materiale të tjera dekorative);
- Të vendosin, në mënyrën e duhur, kallëpet mbi lëkurë;
- Të presin, sipas modelit, me mjetet e duhura, lëkurën;

- Të qepë dhe montojë elemente të thjeshta me material lëkure dhe materialet ndihmëse të galanterisë;
- Të qepë një veshje të thjeshtë lëkure (fund, jelek, etj.);
- Të qepë dhe realizojë një veshje këmbë të thjeshtë (pupë, opingë, papuçe, etj.);
- Të qepë dhe realizojë aksesorë të thjeshtë të ndryshëm (rrip mesi, kuletë, doreza, çantë, kapele);
- Të rregullojë defektet në tegelin e qepjes si: lënie ponti, këputje peri, thyerje e konsumim gjilpërë;
- Të mirëmbajë makineritë dhe makinat qepëse të llojeve të ndryshme për galanteri;
- Të përdorë literaturë profesionale;
- Të respektojë standardet e profesionit;

### **Teknikat e realizimit të rripave**

- Të përzgjedhë materialet e lëkurës dhe aksesorët që përdoren për rripat në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të vizatojë modele të ndryshme të rripave;
- Të vizatojë kategoritë e rripave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;
- Të realizojë skicën teknike dhe kartë-modelin e rripit duke u mbështetur në skicën artistike;
- Të realizojë kartë-modele të prerjes për rripat;
- Të realizojë montimin e të gjitha pjesëve të rripit.

### **Teknika e realizimit të kapelave**

- Të përzgjedhë materialet e lëkurës dhe aksesorët që përdoren për kapelat në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të vizatojë modele të ndryshme të kapelave prej lëkure;
- Të vizatojë kategoritë e kapelave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;
- Të vizatojë pjesët përbërëse të kapelave;
- Të realizojë skicën teknike dhe kartë-modelin e kapelave duke u mbështetur në skicën artistike;
- Të realizojë disa kartë-modele të thjeshta të prerjes së kapelave;
- Të realizojë montimin e të gjitha pjesëve të modeleve për kapele.

### **Teknika e realizimit të dorezave**

- Të përzgjedhë materialet e lëkurës dhe aksesorët që përdoren për dorezat në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të vizatojë modele të ndryshme të dorezave prej lëkure;
- Të vizatojë kategoritë e dorezave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;
- Të vizatojë pjesët përbërëse të dorezave;
- Të realizojë skicën teknike dhe kartë-modelin e dorezave duke u mbështetur në skicën artistike;
- Të realizojë disa kartë-modele të thjeshta të prerjes së dorezave;
- Të realizojë qepje të thjeshta me dorë të dorezave;
- Të realizojë montimin e të gjitha pjesëve të dy modeleve të dorezave.



### **Teknikat e realizimit të çantave**

- Të përzgjedhë materialet dhe aksesorët që përdoren për çantat dhe kuletat në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të vizatojë modele të ndryshme çantash;
- Të vizatojë kategoritë e çantave sipas stilit dhe funksionit si: çanta për blerje (trajse), biznesi, kuleta, sportive, etj.;
- Të vizatojë pjesët përbërëse të çantës dhe kuletës;
- Të vizatojë çanta të llojeve të ndryshme në lidhje me llojin e trupit të çantës si: çantë e fortë, çantë e butë, me pjesë të përziera;
- Të realizojë skicën teknike dhe kartë-modelin e çantës dhe kuletës duke u mbështetur në skicën artistike;
- Të realizojë kartë-modele të prerjes të disa llojeve bazë çantash dhe kuletash;
- Të realizojë montimit e të gjitha pjesëve përbërëse të çantës.

### **Teknikat e realizimit të veshjeve me lëkurë**

- Të përzgjedhë materialet e lëkurës dhe aksesorët që përdoren për realizimin e veshjeve të tilla si: fund, pantallona, jelek, xhaketë;
- Të vizatojë modele të ndryshme të veshjeve të tilla si: fund, pantallona, jelek, xhaketë që realizohen me material lëkure;
- Të realizojë skicën teknike dhe kartë-modelin e veshjeve duke u mbështetur në skicën artistike;
- Të realizojë kartë-modelin për fund dhe jelek;
- Të realizojë montimin e të gjitha pjesëve përbërëse të fundit dhe të jelekut.

### **Teknikat e realizimit të këpucëve**

- Të identifikojë sistemin ndërkombëtar të masës së këpucës;
- Të përzgjedhë materialin e lëkurës në lidhje me formën dhe estetikën e këpucës;
- Të vizatojë lloje dhe tipologji të këpucëve të tilla si: këpucë burrash elegante dhe casual, këpucë për femra me taka dhe të sheshta, me gomë apo me shollë, atlete;
- Të identifikojë rolin dhe funksionin e shollës, të pjesës së gishtave dhe fortesën të thembra;
- Të realizojë skicën teknike dhe kartë-modelin e këpucës (sandales) duke u mbështetur në skicën artistike;
- Të realizojë kartë-modele të këpucëve më të thjeshta, si: balerina, (pupa ose opinga).
- Të realizojë montimin e të gjitha pjesëve përbërëse të këpucëve balerina (pupa ose opinga).

## **KOMPETENCA TE PERGJITHSHME**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.